

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 33, datë 18.12.2018


**Mbi rishikimin e jetës së dobishme të disa aktiveve afatgjata
jo – materiale në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave**

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 10, pika 2/1 të Rregullores “Për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.5, datë 30.03.2017 të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë rishikimin e jetës së dobishme të disa aktiveve afatgjata jo – materiale në Agjenci, sipas tabelës në vijim:

| Nr. | Përshkrimi i aktivitetit jo - material | Vitet e amortizimit efektive nga data 1 janar 2018 |
|-----|---|--|
| 1. | Program kontabiliteti ALPHA | 2 |
| 2. | Furnizim dhe instalim i platformës ERP | 4 |
| 3. | SIRK - Mbledhja e të dhënave dhe raportimi i të dhënave | 4 |
| 4. | Përmirësim i SIRK- Mbledhja e të dhënave dhe raportimi i të dhënave | 4 |
| 5. | Implementimi i ndryshimeve në SIRK | 4 |
| 6. | Portal Web i Agjencisë | 3 |
| 7. | Përmirësime në sistemin ERP | 4 |



KËSHILLI DREJTUES

2. Ngarkohen Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar